

SOILGUARD 1.5 GR

PRODUKT PER MBROJTJEN E BIMEVE



“KUJDES”

“Lexo fletudhëzuesin para përdorimit”

Insekticid piretroid, jo sistemik per kontrollin afatgjate te demtuesve te tokes

Përmbajtja: 15 g/kg Tefluthrin.

Formulimi: Granula (GR).

Masat parambrojtëse:

- P260-Mos merrni/thithni pluhur;
- P264-Lani duart plotësisht pas trajtimit;
- P270- Mos hani, pini ose pini duhan kur përdorni këtë produkt;
- P273-Shmangni lëshimin në mjedis;
- P280- Vishni dorashka mbrojtëse/rroba mbrojtëse/mbrojtëse për fytyrën /sytë;
- P314- Merrni këshilla/vëmendje mjekësore nëse nuk ndiheni mire;
- P391- Mblidheni atë që derdhet;
- P501-Hidhni ambalazhin në pikën e grumbullimit të mbeturinave të rrezikshme ose të veçanta, dhe asgjësoni në përputhje me ligjet në fuqi.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

- H302 – I demshem nëse gëlltitet; P301+ P312 - NËSE GËLLTITET: Telefononi një QENDËR HELMIMI apo një doktor/... nëse nuk ndiheni mire;
- H373 – Mund të shkaktojë dëme në organe përmes ekspozimit të zgjaturose të përsëritur.
- H410 – Shumë toksike për jetën ujore me efekte të gjata;
- Nëse nuk ndiheni mire, kërkoni menjëherë këshillë mjekësore (tregoni etiketën kur është e mundur). Në rast aksidenti, telefononi urgjencën mjekësore.

Përdorimi:

Tefluthrin futet në grupin kimik të piretroideve. Paraqet veprim të fortë kontakti, nepermjet thithjes së tij nga epiderma e insekteve, veprim të brendshëm dhe veprim nepermjet avujve. Manifeston veti repelente. Ka veprim të shpejtë fillestar dhe kohezgjatje të madhe veprimi. Kontrollon me efektivitet të lartë demtuesit e tokës që u perkasin rendeve: Coleoptera, Diptera, Lepidoptera etj (*Agriotes* spp, *Chaetocnema* spp, *Ceuthorynchus* spp, *Delia* spp, *Psila* spp, *Tipula* spp, *Bibio* spp, *Melolontha melolontha*, *Diabrotica* spp, *Scutigerella* spp, *Atomaria linearis*, *Millipedes*, *Centipedes* etj.) tek perimet, bimët e arave dhe tek bimët zbukuruese.

Perdoret në kultura bujqësore: *perime*, *patate*, *miser*, *soje*, *luledielli*, *telashtat*, *bime zbukuruese* etj.

Kunder demtuesve të tokës si: Krimbi tel, krimbi i murrme, zhuzhaku i majte, diabrotika, hundegjati, psyvaspp, tipulaspp, atomarialinear, etj, me dozen 5-7 kg/ha duke e përdorur në rreshta dhe në momentin e mbjelljes së farës ose fidanit në vendin e përhershëm. Në kulturat *perimore* dhe *patate* kur infeksionet vazhdojnë, mund të perseritet trajtimi duke përdorur të njëjtën dozë dhe duke e shoqëruar me prashitje për tembuluar preparatin në tokë. Te perdoret 1-2 here në vit në cdo kulture bujqësore, kontrollon edhe insektet që janë rezistente ndaj insekticideve fosforo-organike dhe karbomate.

Vrejtje për përdorimin:

Nuk rekomandohet perzierja me PMB të tjera.

Fitotoksiciteti:

Nuk është fitotoksik kur perdoret sipas rekomandimeve të mesiperme.

Ndikimi në mjedis:

EUH401– Për të shmangur rreziqet ndaj shëndetit njerëzor dhe mjedisit, zbatoni udhëzimet për përdorim.

SP1 - Mos e ndotni ujin me produktin ose enën e tij. Mos pastroni pajisjet e aplikimit pranë ujit sipërfaqësor. Shmangni ndotjen përmes kanalizimeve nga kopshtet dhe rrugët. SOILGUARD 1.5 GR është pak helmues për bletet, por është helmues për peshqit dhe organizmat ujore. Shperbehet ne toke nga ana e mikroorganizmave dhe nuk akumulohet ne zinxhirin ushqimor.

Karenca:

Nuk kerkohet pasi trajtimi behet qe ne mbjellje.

Kushtet e ruajtjes dhe magazinimi:

Preparati ruhet ne kuti te mbyllura, ne vende te thata e te ftohta, ne temperature deri 40⁰ C. Preparati te mos mbahet ne diell e ne lageshti.

Numri dhe data e regjistrimit: 748, datë 4.12.2020;

Sasia neto e PMB-së apo lëndës vepruese, që ndodhet në ambalazhin bazë: 100 gr, 500 gr, 1000 gr, 5 kg;

Numri i serisë ose shenja të tjera identifikuese: _____;

Data e prodhimit: _____;

Afati i ruajtjes: 3 vjet;

Lloji i ambalazhit bazë: Material 3-shtresor për mbrojtjen nga lagështia;

Emri dhe adresa e aplikantit: Sharda Chropchem Espana SL. **Adresa:** Murcia, Spanjë;

Emri dhe adresa e prodhuesit: Sharda Cropchem Ltd. **Adresa:** Mumbai-Indi.